

EPOXYCOAT-VSF

Shtresë epokside pa tretës, me 2 përbërës

Përshkrimi

EPOXYCOAT-VSF është një sistem epoksid me 2 përbërës që nuk përmban tretës dhe i ngjyrosur, i cili ofron fortësi të madhe dhe rezistencë të lartë ndaj gërryerjes. Ai është i rezistent ndaj acideve, materialeve alkaline, produkteve të naftës, tretësve, ujit, ujit të detit, kushteve të motit etj.

Fushat e përdorimit

EPOXYCOAT-VSF përdoret si shtresë mbrojtëse dhe dekorative për nënshtresat me bazë çimentoje, p.sh. beton, suva, llaç çimentoje për nivelime, si dhe në sipërfaqe metalike. Ai është i përshtatshëm për hapësira në ambiente industriale, laboratorë, thertore, dyqane, fabrika të ushqimit të konservuar, fabrika të prodhimit të verës, pika karburanti, ofiçina etj.

Gjithashtu është e përshtatshme për sipërfaqet me kontakt të drejtpërdrejtë me produktet ushqimore, sipas W-347, ISO 8467.

Të dhënat teknike

Baza:	rrëshirë epokside me 2 përbërës
Ngjyrat:	RAL 7035 (gri ehapur) RAL 7040 (gri) RAL 1015 (bezhë) ngjyrat e tjera me porosi të veçantë
Viskoziteti:	1.550 mPa·s në +23°C
Densiteti:	1,30 kg/litër
Raporti i përzierjes (A:B):	80:20 sipas peshës
Koha e punueshmërisë:	40 minuta në +23°C
Temperatura minimale e mpiksjes:	+8°C
Koha e shkeljes:	pas 24 orësh në +23°C
Shtresa pasuese:	pas 24 orësh në +23°C
Fortësia finale:	pas 7 ditësh në +23°C
Forca ngjitëse:	> 3 N/mm ² së betonit) (pika e thyerjes së betonit)
Pastrimi i veglave:	
Veglat duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit me tretësin SM-12.	

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtresa

Sipërfaqja që do të vishet duhet të jenë:

- E thatë dhe e qëndrueshme.
- Pa materiale që pengojnë ngjitjen, si p.sh. pluhuri, grimcat e lira, grasoja etj.
- E mbrojtur nga sulmi i lagështirës nga poshtë.

Gjithashtu, ajo duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) Nënshtresat me çimento

Cilësia e betonit:	të paktën C20/25
Cilësia e llaçit të çimentos:	përmbajtja e çimentos 350 kg/m ³
Mosha:	të paktën 28 ditë
Niveli i lagështirës:	më pak se 4%

b) Sipërfaqet prej hekuri ose çeliku

Duhet të jenë pa ndryshk ose pa ndonjë papastërti që pengon ngjitjen.

Në varësi të natyrës së nënshtresës, ajo duhet të përgatitet nëpërmjet fërkimit me furçë, gërryerjes, frezimit, rërës me ajër me presion, ujit me presion, fryrjes me presion të saçmave metalike etj. Pas kësaj, sipërfaqja duhet të pastrohet nga pluhuri me një fshesë me vakuum me fuqi të madhe thithëse.

2. Lyerja me astar

a) Nënshtresat me çimento

Sipërfaqet me bazë çimentoje lyhen duke u ngopur me materialin epoksid DUROFLOOR-BI, në një shtresë.

Konsumi i DUROFLOOR-BI: rreth 150 g/m².

b) Nënshtresat metalike

Nënshtresat metalike duhet të lyhen me materialin epoksid anti-korroziv EPOXYCOAT-AC, në 2 shtresa.

Konsumi: 150-200 g/m²/shtresë.

3. Përzierja e përbërësve

Përbërësit A (rrëshira) dhe B (forcuesi) janë të paketuar në dy enë të ndara, të cilat kanë raportin e paracaktuar të përzierjes sipas peshës. E gjithë sasia e përbërësit B shtohet në përbërësin A. Përzierja e 2 përbërësve duhet të bëhet për rreth 5 minuta, duke përdorur një mikser me xhiro të ulët (300 rrot/min). Është e rëndësishme që përzierja të trazohet mirë pranë anëve dhe fundit të enës në mënyrë që të arrihet përhapja uniforme e forcuesit.

EPOXYCOAT-VSF

4. Përdorimi - Konsumi

EPOXYCOAT-VSF duhet të përdoret brenda 24 pas lysterjes dhe pasi është tharë astari.

EPOXYCOAT-VSF përdoret në gjendjen që është. Aplikohet me rul, furçë ose spërkatje, të paktën në 2 duar (shtresa). Shtresa (dora) e dytë bëhet pasi të jetë tharë dora e parë, por brenda 24 orësh.

Konsumi: 200-300 g/m²/shtresë.

Ambalazhimi

EPOXYCOAT-VSF ofrohet në paketime (A+B) prej 2 kg & 10 kg, ku përbërësit A dhe B kanë një raport të fiksuar të peshës.

Magazinimi

Të paktën 12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketimin origjinal të izoluar, në ambiente të mbrojtura nga lagështira dhe ekspozimi në dritën e diellit. Rekomandohet një temperaturë ruajtjeje midis +5°C dhe +35°C.

Shënime

- Punueshmëria e materialeve epokside ndikohet nga temperatura e tyre. Temperatura ideale e përdorimit është midis +15°C dhe +25°C në mënyrë që produkti të jetë i lehtë për t'u përdorur dhe për t'u tharë, ashtu siç shpjegohet më lart. Temperatura e ambientit nën +15°C do të rrisë kohën e tharjes dhe temperatura mbi +30°C do të përshpejtojë kohën e tharjes. Gjatë dimrit rekomandohet një ngrohje paraprake e produktit, kurse në verë rekomandohet ruajtja e materialit në një vend të freskët përpara përdorimit.
- Ngjitja e shtresa pasuese mund të ndikohet ndjeshëm nga ndërhyrja e lagështirës ose papastërtive.
- Shtresat epokside duhet të mbrohen nga lagështira për 4-6 orë pas aplikimit të tyre. Lagështira mund të zbardhë sipërfaqen dhe/ose ta bëjë ngjitëse. Ajo mund të çrregullojë mpiksien gjithashtu. Shtresat e zbehura ose ngjitëse në pjesë të ndryshme të sipërfaqes duhet të hiqen duke u gërryer ose duke u fërkuar dhe pastaj të shtrohen përsëri.

- Nëse një kohë më e gjatë se ajo e parashikuar ndodh midis aplikimeve të shtresave pasardhëse ose në rast se dyshemetë e vjetra do të shtrohen përsëri, sipërfaqja duhet të gërryhet dhe të pastrohet plotësisht përpara aplikimit të një shtrese të re.
- Pas ngurtësimit, EPOXYCOAT-VSF është plotësisht e sigurt për shëndetin.
- Përpara përdorimit, lexoni këshillat e sigurisë të treguara në etiketën e produktit.

2032

ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece

12

2032-CPR-10.11

EN 1504-2

Surface protection products

Coating

Abrasion resistance: < 3000 mg

Capillary absorption: $w < 0.1 \text{ kg/m}^2 \cdot \text{h}^{0.5}$

Resistance to thermal shock: $\geq 2.0 \text{ N/mm}^2$

Impact resistance: Class I

Adhesion: $\geq 3.0 \text{ N/mm}^2$

Reaction to fire: Euroclass F

Dangerous substances comply with 5.3

EPOXYCOAT-VSF

Rezistenca kimike SHTOJCË

Grupi i testit*	T	1d	3d	7d	28d	90d	180d	360d
PG 1 (benzinë)	20°C	A	A	A	A	X	X	X
PG 4 (të gjitha hidrokarburet pa benzen, vajrat e papërdorur lubrifikues si dhe të motorit, karburantet e avionëve, karburanti për ngrohje, nafta; përfshirë PG 2, 3))	20°C	A	A	A	A	X	X	X
PG 4a (benzen)	20°C	A	A	A	A	A	A	X
PG 5 (alkoole me përqendrim maksimal metanoli 48%, eter glikoli)	20°C	A	A	A	X	X	X	X
PG 5a (të gjithë alkoolet dhe eter glikoli)	20°C	A	A	A	X	X	X	K
PG 6a (hidrokarbure halogjene aromatike dhe alifatike)	20°C	K						
PG 7 (estere dhe ketone)	20°C	A	A	A	X	K		
PG 8 ((tretësira ujore të aldehideve alifatike në përqendrim deri në 40%))	20°C	A	A	A	X	X	X	X
PG 9 (((tretësira ujore të acideve organike në përqendrim deri në 10%))	20°C	A	A	A	X	X	X	K
PG 9a (acide organike (acide karboni, përveç acidit formik) dhe kripërat përkatëse (në tretësira ujore))	20°C	A	A	K				
PG 10 (acide inorganike në përqendrim deri në 20%)	20°C	A	A	A	X	X	X	X
PG 11 (alkale joorganike)	20°C	A	A	A	A	A	A	A
PG 15 (etere ciklike dhe aciklike)	20°C	A	A	A	K			
PG 15a (etere aciklike)	20°C	A	A	A	X	X	X	X
Lënda e testit	T	1d	3d	7d	28d	90d	180d	360d
Etanol 96%	20°C	X	X	X	X	X	K	
Amoniak 10%	20°C	A	A	A	X	X	X	X
Karburant për ngrohje	20°C	A	A	A	A	A	A	A
NaOH 50%	20°C	A	A	A	A	A	A	A
Acid nitrik 20%	20°C	A	A	X	X	K		
Acid klorhidrik 37%	20°C	A	A	A	X	X	K	
Acid sulfurik 50%	20°C	A	A	A	X	X	X	X
Acid sulfurik 80%	20°C	A	X	X	X	X	X	X

A: Rezistent

X: Rezistent, por pa çngjyrosje

K: Jorezistent

*sipas EN 13529

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475

www.isomat.al e-mail: support@isomat.eu

Informacioni teknik dhe udhëzimet e dhëna në këtë fletë të dhënash bazohen në njohurinë dhe në përvojën e Departamentit të Kërkimit dhe të Zhvillimit të kompanisë sonë dhe në rezultatet e dala nga përdorimet afatgjata të produktit në praktikë. Rekomandimet dhe sugjerimet që i referohen përdorimit të produktit jepen pa garanci, meqenëse kushtet e terreneve gjatë përdorimeve të tij janë përtej mundësisë së kontrollit të kompanisë sonë. Si rrjedhojë, përdoruesi është përgjegjës për të konfirmuar se produkti i zgjedhur është i përshtatshëm për përdorimin e parashikuar. Botimi aktual i kësaj flete të dhënash teknike anulon automatikisht çdo botim të kaluar që lidhet me të njëjtin produkt.

